

Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së

Sombor, Serbi
8. mund të 2010.

Konsultimet me bashkësinë lokale për themelimin e KOMRA-së janë zhvilluar në objektin e Asamblesë së qytetit të Somborit. Konsultimet i organizoi Liceu i Hapur, organizatë joqeveritare nga Sombori. Në takimin, të cilin e hapi Gojko Mishković (Liceu i Hapur, Sombor) morën pjesë 25 pjesëmarrës. Sqarimin e saj se pse KOMRA, e paraqiti Zsuzsanna Szerencses, gazetare nga Novi Sadi, ndërsa Sandra Orlović (Fondi për të Drejtën Humanitare) prezantoi rrjedhën e deritashme të procesit konsultativ për modelin e KOMRA-së, si dhe udhëhoqi diskutimin në lidhje me modelin e KOMRA-së.

Sugjerimet dhe opinionet e pjesëmarrësve/eve:

KOMRA duhet të na tregojë të vërtetën si kutia e zezë e aeroplanit.

Zakonisht pas fatkeqësive të mëdha kërkohet kutia e zezë, sepse ajo në mënyrë më të saktë jep të dhënat, faktet, apo atë se çka ka ndodhë me të vërtetë dhe si ka ndodhë gjatë fatkeqësisë, ato në fakt janë mundësia që ta kemi një pasqyrë të saktë për ndodhinë. Idenë për formimin e KOMRA-së, gjegjësisht të asaj se deri ku do të na shpijë formimi i KOMRA-së, në fakt e shoh si një kuti të zezë, shumë të rëndësishme dhe të vlefshme, e cila do të duhej të na tregojë se çka ka ndodhë në të vërtetë. (Zsuzsanna Szerencses, Radio Free Europe, Novi Sad, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

KOMRA të merret vetëm me faktet për luftërat, e jo me shkaqet sepse kjo do të na shpijë në relativizmin e tërë procesit.

Pra, kjo pikë është shumë e rëndësishme për mandatin në të ardhmen e KOMRA-së, e ajo është: a do të merret KOMRA vetëm me faktet apo do të vërtetojë edhe shkaqet e luftërave. Qëndrimi im është, natyrisht pa dashtë të prejudioi qëndrimin tuaj, është se para së gjithash duhet të merremi vetëm me faktet e luftërave të kaluara, pra gjatë atyre dhjetë viteve, sepse kam frikë se diskutimi lidhur me shkaqet do të na shpinte në një rrugë dytësore, e cila do të ishte shumë e përshtatshme për manipulime nga ana e spektrit të gjerë politik, dhe se diskutimi për shkaqet së pari do të na shpinte deri te lufta e Dytë Botërore, e pastaj te Beteja e Kosovës, e kështu me radhë deri ne pafundësi. Dhe kjo do të ishte një rrugë e shkëlqyer për relativizmin e tërë këtij procesi. (Dinko Gruhonjiq, Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Vojvodinës, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Unë më shumë jam për opsionin të cilin e propozoi Dinko Gruhonjiq, e ai është që Komisioni të merret më shumë me faktet. Në këtë pjesën ku komisioni do të merrej eventualisht me ndonjë kontekst historik, mendoj se vetë komisioni do të duhej të vlerësojë se cilat ngjarje historike janë relevante por të fokusohet në të ardhmen e saj të largët, mendoj se nuk është e nevojshme, sepse kjo vërtetë do të sillte deri te

situatat tejet të komplikuar. (Olivera Radovanović, Rrjeti i gjelbër, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Anëtarët e komisionit të zgjidhen nga auditori ndërkombëtarë.

Nëse pritet të emërohen persona të mëdhenj jo-politik ndërsa shteti i emëron, ky atëherë thjeshtë është mision i pamundur. Si do të jetë kjo? Unë, në Kroaci nuk njoh asnjë person i cili do të mund të funksionoj në këtë mënyrë. Pas një mendimi të gjatë do të mund ti gjeja dy apo tre, nëse ka. Kjo do të jetë një pengesë e pakalueshme, si ti gjejmë ata. Ndoshta është ndonjë model boshnjak i cili është treguar jo efikas, ndonjë komisioner ndërkombëtarë, auditor (revizioner) i cili do të tentojë ti tejkalojë dallimet e pakalueshme të cilat do të paraqiten në interpretimin e kësaj për çka po flasim, gjegjësisht ndaj kryesve të krimeve. (Jaroslav Peqnik, Fakulteti Teologjik – Evangjelistik, Osijek, Kroaci, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Duhet të përcaktohet qëndrimin në lidhje me luftën – a ka qenë luftë qytetare apo agresion?

E tani këtu qëndron problemi edhe për KOMRA-në, a ka qenë luftë qytetare apo agresion, për këtë duhet të dakordohemi. Sepse nga ai qëndrim apo pozicion do të dimë se për çfarë të flasim, si do t'i definojmë ato viktimat. Natyrisht, për atë që ka rënë kjo nuk është e rëndësishme, por për ne që jemi gjallë, ne duhet ta dimë se nga çfarë pozicioni do të fillojmë. Unë jam për një zgjidhje kompromisi, se kanë qenë të dyja, se sigurisht ka pas elemente të luftës qytetare, dhe deshëm apo nuk deshëm ka pas edhe elemente të agresionit. (Jaroslav Peqnik, Fakulteti Teologjik – Evangjelistin, Osijek, Kroaci, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Është me rëndësi të vërtetohet regjistri i të vrarëve, përndjekurve, dhunuarve dhe viktimave të krimeve tjera.

Dëshiroj të sqaroj se detyra e KOMRA-së është të hartojë një bazë të të dhënave, një listë apo regjistër të viktimave, kjo nuk është gjykatë, por ajo listë e viktimave mund të ndihmojë në gjykata që të zhvillohen gjykimet, nëse janë të vullnetit t'i zhvillojnë ato. Ajo listë është shumë e rëndësishme për tu vërtetuar se sa ka pasë saktë të vrarë, të përndjekur, të dhunuar dhe krime tjera, që është shumë me rëndësi, që të mos na përsëritet Jasenovci ku janë 700.000, 70.000 apo 7.000, kjo është e rëndësishme për fëmijët tanë. (Ivan Prishing, Sombor, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Detyra e komisionit që të gjitha rezultatet të hynë në librat shkollorë të historisë.

Madje edhe në takimin e fundit mes presidentëve Tadiq dhe Josipović, presidenti Tadiq ka thënë se nuk e kemi një libër të përbashkët të historisë, prandaj mendoj se detyra e këtij komisioni është që kur ta vërtetojë numrin e krimeve të cilat kanë ndodhë në këto hapësira, që ato të dhëna të futen në të gjithë librat e historisë të shteteve të dala pas shkatërrimit të Jugosllavisë. (Ivan Prishing, Sombor, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Të përfshihet mobilizimi i detyruar i qytetarëve.

Unë propozoj që në këto lloje të shkeljeve, për çka edhe ka qenë propozimi i mbajtjes së këtij sesioni të KOMRA-së sot, në Sombor, e ajo është që të përfshihet edhe mobilizimi i detyruar, sepse edhe kjo është shkelje e të drejtave të njeriut. (Olivera Radovanoviq, Rrjeti i gjelbër i Vojvodinës, Novi Sad, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

E mbështesë plotësisht këtë iniciativë, që në kuadër të llojeve të shkeljeve të futet edhe mobilizimi i detyruar në luftërat që janë zhvilluar, dhe atë mobilizimet pa marrë parasysh se nga cila anë vinë, nga ushtria UPJ-së, apo nga Kroacia, Bosnjë e Hercegovina, për mua është krejt e njëjtë se kur dikush është mobilizuar. (Zlatko Romiq, korrespondent i Dnevnik-ut, Suboticë, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Koalicioni për KOMRA-në ti propozojë anëtarët e vet.

Ndoshta do të ishte mirë, nëse disa prej anëtarëve të jenë nga radhët e organizatave të cilat janë themeluese të KOMRA-së, ndoshta vetë KOMRA të jetë ajo e cila do të propozojë me konsensus, të miratojë dhe propozojë me konsensus disa persona të cilët i vlerësojnë ata. (Olivera Radovanoviq, Rrjeti i gjelbër i Vojvodinës, Novi Sad, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Zgjedhja e komisionerëve duhet të bazohet në konsensus.

Ashtu që të jetë një kriter për zgjedhjen e njerëzve do të mund të ishte, që të gjitha shtetet në rajon të pajtohen me konsensus për zgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e caktuara, kështu për shembull, nëse Serbia propozon kandidatët e saj, atëherë ata kandidatët do të duhej të kenë miratimin edhe në shtete tjera në rajon. (Dushko Mediq, Rrjeti i gjelbër i Vojvodinës, Novi Sad, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Të shqyrtohet përgjegjësia e gazetarëve.

Nuk di se në çfarë mënyre, por mendoj se do të duhej të mendohet edhe për rolin e gazetarëve të tërë këtë tregim, sepse ata me veprat dhe veprimet e tyre i kanë gjeneralizuar shumë krime, për të cilat sigurisht do të flasim më vonë. (Zlatko Romiq, korrespondent i Dnevnik-ut, Suboticë, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Thellimi në kontekstin e luftërave mund të jetë tentim i kërkimit për arsyetimin e krimeve.

Jam i prirur të pohoj se nuk kemi nevojë të thellohemi aq shumë në kontekstet historike të ngjarjeve të viteve të 90-ta, sepse jam i prirur të besoj apo të pohoj se ndoshta vetëm po duam të kërkojmë arsyetimin për krimet. Mendoj se ne nuk duhet ti arsyetojmë krimet, ne duhet ato ti evidentojmë në mënyrë faktografike (me fakte), ti kemi faktet dhe dëshmitë për të gjitha ato që dikush i ka bërë në emrin tonë, dhe për atë se, ata të cilët janë përgjegjës për te, kur vinë në posedim të një dokumenti të tillë, i cili faktikisht do të jetë enciklopedi e të vërtetës që ka ndodhë këtu, që të mund ta marrin një vendim të drejtë për gjeneratat e ardhshme dhe që kjo mos të përsëritet. (Miodrag Tepavac, Qendra për punë

sociale, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)

Zbardhja e kontekstit historik është kafshatë e madhe.

Pra, nëse flasim për fazën e dytë, thënë kushtimisht, siç e kam quajtur unë, mendoj se do të ishte kafshatë e madhe, dhe sipas mendimit tim do të ishte rrezik i madh poqëse menjëherë do të futeshim në zbardhjen e kontekstit të tërë historik. (Zsuzsanna Szerencses, Radio Free Europe, Novi Sad, Serbi, Konsultimet me bashkësitë lokale mbi iniciativën për themelimin e KOMRA-së, Sombor, Serbi, 8. maj 2010.)